



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



KOMUNA E KAÇANIKUT
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Data	15.02.19	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri	
	01	49003-4574	Y.

RAPORTI VJETOR
LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA
DHE AKTIVITETET E AUDITIMIT TE BRENDSHËM PËR
VITIN 2018

Kaçanik, janar 2019

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave.....	3
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
2. HYRJE.....	5
3.QËLLIMI I RAPORIT VJETOR, LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA DHE AKTIVITETE E AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	6
3.1. Aktivitetet e NJAB.....	6
3.1.1. Auditimet e kryera gjate vitit 2018.....	7
3.1.2. Planifikim strategjik dhe vjetor.....	8
3.1.3. Aktivitete tjera te NJAB-Takime dhe trajnime te AB.....	9
3.1.4. Aktivitete tjera dhe pune administrative.....	9
4. KONKLuzionET.....	10
5. REKOMANDIMET.....	10

LISTA E SHKURTESAVE

1. **NJAB** - Njësia e Auditimit të Brendshëm
2. **NJQH/AB** – Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm
3. **SSP** - Subjekti i Sektorit Publik
4. **IAB** - Instituti i Auditimit të Brendshëm
5. **AB** – Auditori Brendshëm
6. **AJ**-Auditori i jashtëm
- 7.**KBFP**-Kontrolli i brendshme i financave publike

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport në përgjithësi prezanton zhvillimet në fushën e auditimit të brendshëm në komunën Kaçanikut për vitin 2018.

Këtu përfshihen aktivitetet e NJAB, konkluzionet dhe rekomandimet për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik .

Auditimi i brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës funksionon në mënyrë të decentralizuar, me palët e interesuara në vijim: Njësitë e Auditimit të Brendshëm, Auditorët e Brendshëm, Komiteti i Auditimit, Menaxhmenti i lartë si dhe NJQHA.

NJAB gjatë 2018 ka realizuar të gjitha aktivitetet e auditimit të planifikuara me plan, por sfida për NJAB është niveli i ulët e zbatimit të rekomandimeve dhe funksionalizimi i komitetit të auditimit .

Ndikimi i punës së auditimit të brendshëm gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve dhe mbështetja sistematike e komitetit të auditimit

Rekomandimet tona kryesore janë:

- Menaxhmenti të përgatit me kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditorët dhe të ndërmer veprime për zbatimin e rekomandimeve nga njësitë përgjegjëse.
- Zbatimi i ligjit të auditimit të brendshëm, funksionalizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2009, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm
- Menaxhmenti të përgatis listat e rreziqeve të mundshme dhe komfor tyre të ndërmer masat e nevojshme për parandalimin e tyre.
- Komiteti i auditimit të rishikojë burimet, planet dhe rezultate e NJAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës

2. HYRJE

Raporti është përgatitur në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për kontrollin e brendshme të financave publike, duke paraqitur një analizë mbi të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Raporti vjetor për vitin 2018 është përgatit bazuar në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (KBFP) dhe nenin 25 paragrafi 3.5 të Ligjit për KBFP, drejtori i NJAB çdo vit kalendarik përgatit dhe dërgon raporte vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit të njësisë së auditimit të brendshëm tek menaxhmenti i lartë i SSP (kryetarit), NJQH-AB dhe e njofton komitetin e auditimit të organizatës buxhetore.

Raporti paraqet rezultatet kryesore të aktiviteteve të auditimit të brendshëm në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2018 si dhe të aktiviteteve të NJAB, krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

3.QËLLIMI I RAPORIT VJETOR, LIDHUR ME AUDITIMET E BRENDSHME TË KRYERA DHE AKTIVITETET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm" është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerat dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të përmbush objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes"

Qëllimi i këtij raporti është përmbushja e detyrave dhe përgjegjësi të NJAB në bazë të ligjit të KBFP Nr. 06/L-021 dhe përmbushjes së detyrave dhe obligimeve karshi planit vjetor dhe shkallën e realizimit të tij..

3.1.Aktivitetet e planifikuara NJAB

Objektivë e auditimit të brendshëm është vlerësimi i proceseve të veprimit të kontrollit përbrenda organizatës bazuar në vlerësimet e përshtatshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e audituara.

NJAB gjatë vitit 2018 aktivitetin e vet e ka zhvilluar duke u bazuar në Planin e Punës për vitin 2018 i cili është në harmoni të plotë me strategjinë për funksionimin e auditimit të brendshëm, Planin strategjik për vitet 2018-2020 në bazë të resurseve njerëzore në momentin aktual.

Aktivitetet kryesore të NJAB për vitin 2018 kanë qenë të përqendruara në përmbushjen e planit vjetor dhe atë:

3.1.1.Aktivitete të auditimit:

1. Auditimi "Shpenzimet në arsim dhe kulturë për vitin 2017"
2. Auditimi "Menaxhimi i pasurisë për vitin 2017"
3. Auditimi "Shpenzimet për investime kapitale për Qershor 2017-Maj 2018"
4. Auditimi "Të hyrat në drejtorinë e urbanizimit, kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit për periudhën Janar-Qershor 2018"
5. Auditimi "Proceset e prokurimit për vitin 2018"
6. Auditimi me kërkesë të menaxhmentit

3.1.2. Përgatitja e planit strategjik dhe vjetor

3.1.3. Aktivitete tjera, trajnime të ndryshme për arsimim të vazhdueshëm profesional dhe takime të ndryshme me Komitetin e auditimit, NJQH AB, AJ, pjesëmarrje në mbledhjet e kuvendit e kuvendit etj.

3.1.4. Punë administrative-hartimi i raporteve vjetore dhe tremujore, Përcjellja e implementimit të rekomandimeve, përgatitja e mbledhjeve të komitetit të auditimit , përgatitja e materialeve për AJ etj.

3.1.1. Auditimet e kryera gjatë vitit 2018

Gjatë vitit 2018 NJAB ka kryer të gjitha auditimet e planifikuara. Këtu janë përfshirë (5) auditime, prej tyre 3 auditime kanë qenë auditime me rrezikshmëri të lartë, 2 auditim me rrezikshmëri të mesme.

Këto uauditime përfshijnë auditimet e sistemit të pajtueshmërisë dhe rregullsisë, të cilat kryesisht kanë mbuluar me auditivet në këto fusha: Shpenzimeve për mallra dhe shërbime në arsim, menaxhimi i pasurisë, shpenzimet për investime kapitale, të hyrat në drejtorinë e urbanizimit dhe kadastrit dhe procedurat e prokurimit.

Fushëveprimi i auditimeve të kryera është kryesisht auditime të vitit aktual dhe vitit paraparak. Ditët në dispozicion të planifikuara për aktivitetet e auditimit kane qenë 142 dite, ndërsa për kryerjen e auditimeve gjatë vitit 2018 janë shpenzuar 133 dite pune, apo 69.27 e ditëve efektive.

Plani është realizuar sipas parashikimeve(93.66%) ku janë kryer pesë (5) raporte finale për të gjitha auditimet e planifikuara. Gjate kësaj periudhe nuk kemi pas anje auditim me kerkese te menaxhmentit, per te cilin kane qenë të planifikuara 12 dite.

Por gjatë kësaj periudhe kemi pas angazhime të pa planifikuara me ekspertin e USAD-it për përkrahje në zbatimin e rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditimit dhe trajnime te pa planifikuara.

Si rezultat i këtyre auditimeve, janë dhënë rekomandime 20 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Nga 20 rekomandimet e dhëna , 5 rekomandime janë të dhëna në raportin në fund të periudhës raportuese, ku adresimi i tyre pritet të bëhet gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit janë zbatuar 8 rekomandime, 8 rekomandime janë në proces dhe 4 rekomandime janë të pa zbatuara.

Nëse krahasojmë në përqindje (%) nga të gjitha rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2018:

- Rekomandimet e zbatuara 40%
- Rekomandimet pjesërisht të zbatuara(në procedurë) 40% dhe
- Rekomandimet e pa zbatuara 20%.

Nr. Rend	Emri I auditimit	numri rekomandi meve	Te zbatuara	proces	Pa zbatuara
1	Shpenzimet në arsim dhe kulturë për vitin 2017”	5	4	1	0
2.	Menaxhimi i pasurisë për vitin 2017	3	0	1	2
3.	“Shpenzimet për investime kapitale për Qershor 2017-Maj 2018”	5	4	0	1
4	Auditimi “Të hyrat në drejtorinë e urbanizimit, kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit për periudhën Janar-Qershor 2018”	2	0	1	1
5	Procedurat e prokurimit për vitin 2018	5	0	5	0

Totali	20	8	8	4
---------------	-----------	----------	----------	----------

Edhe pse ekzistojnë shumë të gjetura individuale, që shpjen drejt rekomandimeve, ato mund të grupohen në kategoritë e përgjithshme në vijim:

- Dobësi në menaxhimin e pasurive
- Dobësi ne procedurat e planifikimit te investimeve publike
- Dobësi në proceset e të hyrave
- Dobësi në prokurim me theks të veçantë në menaxhimin e projekteve.

Për të gjitha këto të gjetura janë dhënë rekomandime adekuate për përmirësimin. Janë përgatit draft raportet dhe u janë përcjell menaxhmenti të njësisë së audituar. Shumica draft raporteve e janë diskutuar me menaxhmentin, por menaxhmenti nuk ka përgatit plan për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Raportet finale janë përcjell kryetarit, komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të njësisë së audituar

Rekomandimet e zbatuara kane qenë në ekzekutimin e buxhetit, kryerjen e obligimeve në afat ligjor, procesin e regjistrimit dhe pagesave të shpenzimeve, autorizimit shpenzimeve, kontrollimi dhe monitorimi shpenzimeve.

Rekomandimet në proces janë rekomandimet në prokurim(5) të cilat do të adresohen në vitin 2019, pasi që ky auditim është finalizuar në fund të vitit. Gjithashtu ne proces janë rekomandimi për regjistrimin dhe verifikimi i pasurive të komisionit të regjistrimit dhe barazimi i të hyrave mes drejtorisë dhe zyrtarit të të hyrave.

3.1.2. Planifikim strategjik dhe vjetor

Planifikimi është një funksion themelor menaxherial për të gjitha SSP.

Planifikimi përfshinë zhvillimin e planit strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm, i cili duhet të jetë në pajtueshmëri me qëllimet dhe planet e organizatës të përcaktuara në bazë të Statutit të Komunës, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji mbi Financat Publike, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Korniza afatmesme buxhetore 2019-2021, Ligji e Prokurimit, Strategjinë Zhvillimore të Kaçanikut për vitet 2017-2019, Rregulloret dhe Udhëzimet e aplikueshme të thesarit si dhe të gjeturat nga auditimet e mëparshme.

Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlersimit të rrezikut dhe në pajtim me Ligjin e Kontrollit Brendshëm të Finacave Publike, Standardet e Auditimit të Brendshëm, Kodin e etikës së Auditorëve të Brendshëm dhe Metodologjinë për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm.

Plani strategjik 2019-2021 dhe plani vjetor për vitin 2019 i Njesise se Auditimit të Brendshëm është përgatit nga auditorja e brendshme, në bazë të vlerësimit të rrezikut. Vlerësimi i rrezikut është bazuar në informacionet e grumbulluara përmes metodave si: takimeve dhe intervistave me menaxhmentët e drejtorive komunale, zyrtarë të ndryshëm komunal, pastaj nga analizat e rezultateve të dalura nga auditimet e mëparshme, nga informacionet që ofrojnë qasje publike si dhe nga burime të tjera.

Këto plane janë miratuar nga menaxhmenti i lartë dhe komiteti i auditimit dhe pas miratimit janë dorëzuar në NJQH/AB në afatin ligjor.

Plani vjetor i auditimit është i ndarë nga plani strategjik dhe në të specifikohen auditimet që duhet të kryhen, fushëveprimi i tyre, objektivat, afatin kohor.

Ky aktivitet është realizuar sipas planifikimeve të parashikuara me plan të punës për vitin 2018 (100%).

3.1.3. Aktivitete tjera të NJAB –takime dhe trajnime të auditimit të brendshëm

Pos detyrave të auditimit të planifikuara kam marrë pjesë edhe në trajnimet e organizuara nga NJQH-AB, në bashkëpunim me donatorët (Projekti i USAID për komuna transparente, efektiv edhe llogaridhënëse), Instituti kosovar për qeverisje lokale në këto fusha :

- Prezantimi i përvojave praktike në fushën e auditimit të brendshëm
- Prokurim Publik
- Tryeze për ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira ndërkombëtare të auditimit të brendshëm
- Prokurim publik dhe zbulimi i mashtrimit
- Standardet ndërkombëtare të auditimit
- Planifikimi Strategjik dhe vjetor
- Ngritja e kapaciteteve të zyrave të auditorit të brendshëm për monitorim, vlerësim dhe këshillim
- Auditimi i brendshëm në nivel komunal-sfidat dhe rekomandimet etj.

Gjithashtu kam marrë pjesë në takime me menaxhmentin, me NJQH, me auditorët e jashtëm, takime me Zyrën kombëtare të auditimit , pjesëmarrje në mbledhje të kuvendit, Takime me ekspertin e USADI-it për përkrahje në zbatimin e rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditimit dhe takime tjera fushën e auditimit.

Realizimi i trajnimeve dhe takimeve të ndryshme është mbi parashikimet, për arsye se organizimi i trajnimeve nuk varet nga kërkesat tona , ne nuk kemi buxhet të ndarë për trajnime, NJQH është përgjegjëse për hartimin e programeve të trajnimit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe organizimin e trajnimeve, hartimin dhe administrimin e politikave kombëtare për trajnimin, certifikimin dhe për zhvillim të vazhdueshëm profesional të auditorëve të brendshëm, sipas praktikave ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm si dhe për organizimin e trajnimeve.

Gjate këtij viti janë mbajtur katër (4) takime me komitetin e auditimit ku janë shqyrtuar të gjitha raportet e auditimit të brendshëm , rishikimin e përgjigjes së menaxhmentit ndaj të gjitha rekomandimeve, përcjellja e realizimit të planit vjetor, rishikimi dhe miratimi i planit strategjik 2019-2021 dhe planit vjetor për vitin 2019 të NJAB dhe janë dhënë rekomandime për përmirësim.

3.1.4. Punë tjera administrative:

Me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorit të NJAB në bazë të nenit 25 , paragrafi 3.5 , nenit 16 dhe nenit 21 paragrafi 1 i ligjin nr. nr. 06/L-021, për

Kontrollin e Brendshëm te financave publike, kam përgatitë dhe dorëzuar raportet tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore të NJAB në NJQH, menaxhmentit e larte-Kryetarit dhe Komitetit te auditimit. Të gjitha raporte janë dorëzuar në afatet ligjore.

Një ndër aktivitete e planifikuara me plan të punës për vitin 2018 është edhe përcjellja e implementimit te rekomandimeve, përgatitja e materialeve për AJ dhe punë tjera administrative në kuadër të fushës se auditimit, të cilat janë kryer sipas parashikimeve.

4. KONKLuzionET

NJAB gjatë 2018 ka realizuar gjitha aktivitete e auditimit të planifikuara me plan, por sfida për NJAB është niveli i ulët e zbatimit të rekomandimeve dhe mungesa e burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave strategjike të NJAB.

Në krahasim me vitin me paraprak kemi një përmirësim në zbatimin e rekomandimeve për 15%.

Ndikimi i punës se auditimit të brendshëm gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve dhe mbështetja sistematike e komitetit të auditimit.

5. REKOMANDIMET

Për të adresuar çështjet e paraqitura në seksionet e mëparshme, ne rekomandojmë veprimet në vijim:

- Menaxhmenti të përgatit me kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditorët dhe të ndërmer veprime për zbatimin e rekomandimeve nga njësitë përgjegjëse.
- Zbatimi i ligjit të auditivit të brendshëm, funksionalizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2009, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm
- Menaxhmenti të përgatis listat e rreziqeve të mundshme dhe komfor tyre të ndërmer masat e nevojshme për parandalimin e tyre.
- Komiteti i auditimit të rishikojë burimet, planet dhe rezultate e NJAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës

Kefsere Koxha

Auditore brendshme

